

VENDIM
Nr. 129, datë 11.2.2015

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “KOMUNA E PARISIT - RRUGA E RE TIRANË - ELBASAN”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik”, dhe të ligjit nr.160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Komuna e Parisit - Rruga e Re Tiranë - Elbasan”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për tokë bujqësore, me sipërfaqe të përgjithshme prej 4 345 (katër mijë e treqind e dyzet e pesë) m², dhe me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 37 051 988 (tridhjetë e shtatë milionë e pesëdhjetë e një mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë.

4. Vlera përgjithshme e shpronësimit, prej 37 051 988 (tridhjetë e shtatë milionë e pesëdhjetë e një mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tetë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, zëri “Shpronësime”, planifikuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive të listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar ZVRPP-ja”, të likuidohen për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë, që do të dorëzojnë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimet për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6 dhe 7, të këtij vendimi.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’i vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe, me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës mbi hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA SHITESË E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË RRUGËS "UNAZA E MADHE TIRANË"
 SEGMENTI "KOMUNA E PARISIT -RRUGA E RE TIRANË ELBASAN"

Nr.	PRONAR I			Z.K	Nr. pasurie	Lloji ipasurisë	Sip. (m²)	Çmimi (l/m²)	Vlera totale (lekë)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri							
1	AGIM	ISLAM	ALLA	3292	100/4	Arë	898	8,528	7,657,695	Konfirmuar ZVRPP
2	RAMAZAN	ISLAM	ALLA	3292	101/28	Vresht	1159	8,528	9,883,373	Konfirmuar ZVRPP
3	HAKI	ISLAM	ALLA	3292	101/29	Vresht	1074	8,528	9,158,535	Konfirmuar ZVRPP
4	NUREDIN	ISLAM	ALLA	3292	101/45	Vresht	1214	8,528	10,352,385	Konfirmuar ZVRPP
	Shuma						4345		37,051,988	